



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0004832-2/16, dt. 03.02.2026
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Propozim – Vendimit të Drejtorisë për Administratë të Përgjithme Nr. 01-020/04-0004832/26, dt. 27.01.2026, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

(Për formimin e Komisionit për Verifikimin/Pranimin e Donacioneve në emër të Komunës së Mitrovicës së Jugut)

1. Formohet Komisioni për Verifikimin/Pranimin e Donacioneve në emër të Komunës së Mitrovicës së Jugut, në këtë përbërje:
 - 1.1. Skofiar Sylja – kryetar, (DAP);
 - 1.2. Idriz Gashi – anëtar, (DAP);
 - 1.3. Fitim Rama – anëtar, (DAP).
2. Komisioni është përgjegjës që të bëjë Verifikimin dhe Pranimin e Donacioneve që janë të dedikuara për Komunën e Mitrovicës së Jugut, nga Donatorët e ndryshëm brenda dhe jashtë vendit.
3. Komisioni punues bazë për punën e tij do të ketë aktet ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse, që kanë të bëjnë me pranimin e donacioneve.
4. Për çdo donacion të pranuar për Komunën, Komisioni i lartëkur obligohet që të hartojë raport me shkrim, duke përshkruar gjendjen faktike të sendeve të luajtshme të pranuar donacion, dhe të njëjtin përmes Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme t'ia prezantojë Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
5. Komisioni i formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi ka mandat 1 (një) vjeçar.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Shtojcë:

1x1 Propozim – Vendimi i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme, Nr. 01-020/04-0004832/26, dt. 27.01.2026.

T'i dërgohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme
- 1x1 Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- 1x1 Anëtarëve të Komisionit
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Arkivit

